

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor

1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin. 2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton. 3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.

Constitutional Paragraph: Neni 52 para 2

Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.

Instrumentet ndërkombëtare

Nenet

Konventa për Eliminimin e
të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas
Konventa për Eliminimin e
të gjitha Formave të
Diskriminimit ndaj Gruas

Neni 7

(b) Për t' marrë pjesë në përpunimin e politikës së shtetit dhe në zbatimin e saj; për t' mbajtur poste publike dhe për t' ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes;

Neni 25

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

Çdo qytetar ka t' drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme: (a) T' marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht; (b) T' votojë dhe t' zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve; (c) T' pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për t' ushtruar funksione publike në vendin e tij.

**Instrumentet
ndërkombëtare**

Nenet

Neni 11

Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.
2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

Neni 21

Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut

1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Secili ka njësoj të drejtë të hyjë në shërbimet publike të vendit të vet.
3. Vullneti i popullit është bazë e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhjet e herëpëherëshme dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe me votë barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Konventa Kornizë e
Këshillit të Evropës për
Mbrojtjen e Pakicave
Kombëtare
Konventa Kornizë e
Këshillit të Evropës për
Mbrojtjen e Pakicave
Kombëtare

Neni 15

Palët do të krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen aktive të personave që i përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në çështjet publike, veçanërisht për ato që ndikojnë mbi ta.

Ligjet

Nenet

Neni 6

1. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, është zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes pa prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm t'i plotësojnë nevojat e tyre. 2. Parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit. Autoritetet publike do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për zhvillimin dhe adoptimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit. 3. Parimet e harmonizimit gradual me standardet e Bashkimit Evropian. Mbrojtja e mjedisit do të bazohet në sjelljen graduale të standardeve të Bashkimit Evropian me qëllim krijimin e detyrueshëm të një mjedisi të shëndoshë për njeriun në parimet e ushtrimit të një praktike sa më adekuate, të adoptuar brenda komunitetit shkencor, për përmirësimin e mjedisit. 4. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit, deri në pikën e veprimit të arsyeshëm, duke konsideruar shpenzimet dhe përfitimet e pritura mjedisore, një aktivitet do të planifikohet dhe zbatohet në atë mënyrë që të parandalojë ose të ndërpresë efektet e dëmshme në mjedis pa rrezikimin e shëndetit të njeriut. 5. Parimi i parandalimit zbatohet përmes Vlerësimit Strategjik Mjedisor, Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe zbatimin e Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjes. 6. Mungesa e njohurive të tërësishme shkencore nuk mund të jetë arsye për mos ndërmarrjen e masave parandaluese të pengimit të rrezikimit dhe degradimit të mjedisit, në rastet e mundshme ose ekzistuese që kanë ndikim të mundshëm në mjedis. 7. Parimi “ndotësi paguan” ndotësi paguan kompensimin për ndotjen e mjedisit nëse gjatë aktivitetit të vet shkakton ngarkesë në mjedis me prodhimin, shfrytëzimin ose vënien në qarkullimit të lëndës së parë, gjysmë prodhimit ose prodhimit i cili përmban materie të dëmshme për mjedisin. 8. Parimi “shfrytëzuesi paguan“, shfrytëzuesi i resurseve natyrore detyrohet të paguajë një çmim real për shfrytëzimin e tyre dhe të rikultivojë hapësirën pas përfundimit të aktiviteteve shfrytëzuese. 9. Parimi i përgjegjësisë subsidiare, në rastet kur përgjegjësia për ndotje nuk mund të konstatohet atëherë përballimin e kostos së rehabilitimit dhe zvogëlimit të ndotjes në mjedis e bartin institucionet shtetërore. 10. Parimi i masave inkurajuese, Qeveria do të promovojë praktikën dhe aktivitetet që kanë për qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes me masa inkurajuese dhe stimuluese për personat juridik e fizik të cilët zgjedhin teknikat më të mira të mundshme dhe prodhimtari të pastër. 11. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë, çdo person juridik ose fizik dhe publiku, në rast të pësimit të dëmit material ose është para një rreziku të pësosh dëm material që ka të bëjë me një aktivitet të veçantë ose burim të ndotjes që bën shkeljen e dispozitave të këtij ligji, ligjeve të veçanta ose akteve nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit, ka të drejtë të ngre padi ose të kërkojë nga gjykata kompetente ose autoriteti publik të mbroj të drejtat e veta. 12. Parimi i qasjes së publikut në informata. Secili person juridik ose fizik ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje. 13. Parimi i nivelit të lartë të mbrojtjes. 14. Parimi i përputhshmërisë me ligjin e Bashkimit Evropian. 15. Parimi i masave paraprake. 16. Parimi që nënkupton se dëmi mjedisor duhet të rregullohet në burim. 17. Parimi i mbulimit të shpenzimeve.

LIGJI NR.03/L-025
PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT
LIGJI NR.03/L-025
PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT

LIGJI NR.03/L-025
PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT
LIGJI NR.03/L-025
PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT

Neni 6. (Parimet)

6.12. Parimi i qasjes së publikut në informata. Secili person juridik ose fizik ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe të marrë pjesë në vendimmarrje.

LIGJI NR.03/L-025
PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT
LIGJI NR.03/L-025
PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT

Neni 58

Kufizimi i pjesëmarrjes së publikut në marrjen e vendimit Qeveria më qëllim të ruajtjes së interesit të mbrojtjes dhe sigurisë së vendit, mund të kufizojë pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimit, nga neni 57 të këtij ligji.

LIGJI NR. 03/L-040
PËR
VETËQEVERISJEN
LOKALE,
LIGJI NR. 03/L-040
PËR
VETËQEVERISJEN
LOKALE,

Neni 68

68.1 Çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara. Njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. 68.2 Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal. 68.3 Përveç takimeve publike të cekura më lartë, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës. 68.4 Kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale mund të nxjerrë udhëzime administrative për transparencë komunale. 68.5 Çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 73

Komitetet konsultative

LIGJI NR. 03/L-040
PËR
VETËQEVERISJEN
LOKALE,
LIGJI NR. 03/L-040
PËR
VETËQEVERISJEN
LOKALE,

73.1 Kuvendi i komunës themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

73.2 Anëtarësi e komiteteve përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

73.3 Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e kuvendit të komunës, në pajtim me statutin e komunës.

Neni 2

LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES
LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES

1. Ky ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të sajë dhe veçanërisht: 1.1. mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore; 1.2. përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara; 1.3. vendosjen e rrejtjeve të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës; 1.4. pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre; 1.5. sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës; 1.6. sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë; 1.7. parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike; 1.8. mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së; 1.9. ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve të cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

Neni 5

Parimet e Mbrojtjes së Natyrës

LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES
LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES

1. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës bazohet në parimet: 1.1. Parimi i përkujdesjes – kur bazuar në njohurit shkencore dhe tekniko- teknologjike konstatohet se një aktivitet i veçantë ose veprim mund të dëmtoj natyrën, masat dhe aktivitetet e domosdoshme duhet të ndërmerren përpara se dëmet mund të ndodhin. 1.2. Parimi i integritetit – masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e natyrës duhet të integrohen në të gjitha planet zhvillimore strategjike, dokumentet dhe programet e planifikimit hapësinor, planet zhvillimore hapësinore si dhe planet për menaxhimin dhe shfrytëzimin e të mirave të natyrës. 1.3. Parimi shfrytëzuesi paguan – kur shfrytëzon natyrën shfrytëzuesi është i detyruar që të paguaj për lartësinë e shpenzimeve të mirëmbajtjes së baraspeshës natyrore dhe shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore si dhe të sanoj dëmtimin e natyrës që ka ndodhur gjatë shfrytëzimit të natyrës dhe trashëgimisë natyrore. 1.4. Parimi i proporcionalitetit - të mirat natyrore të pa përtëritshme duhet shfrytëzuar në mënyrë racionale, ndërsa ato të ripërtëritshme në mënyrë të qëndrueshme. 1.5. Parimi i pjesëmarrjes së publikut - publiku ka të drejt për qasje në informatat për gjendjen e natyrës, të drejt ne informimin me kohë për dëmet në natyrë, masat e ndërmarra për eliminimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe të drejtën dhe mundësin e pjesëmarrjes në vendim marrje për natyrën. 1.6. Parimi i përgjegjësisë subsidiare - në rastet kur përgjegjësia për dëmin nuk dihet atëherë përbalimin e kostos së rehabilitimit dhe zvogëlimit dëmit në natyrë e bartin institucionet shtetërore. 1.7. Parimi i parandalimit – është e drejtë dhe detyrim i çdo personi juridik a fizik që të ndërmerr masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e natyrës përpara se dëmi të ndodh. 1.8. Parimi i bashkëpunimit - në shfrytëzimin e të mirave të natyrës dhe planifikimin e hapësirës personat juridik dhe fizik detyrohen tu përmbahen parimeve, masave dhe kushteve të mbrojtjes së natyrës. 2. Në mbrojtjen dhe përparimin e natyrës do të zbatohen parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit në pajtim me ligjin.

Neni 6

Zbatimit i mbrojtjes së natyrës

LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES
LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES

1. Mbrojtja e natyrës zbatohet përmes ruajtjes së larmisë biologjike, peizazhore dhe vlerave të natyrës. 2. Mbrojtja e natyrës zbatohet veçanërisht përmes: 2.1. përcaktimit dhe vlerësimit të gjendjes së përbërësve të larmisë biologjike dhe peizazhore; 2.2. zbatimit të masave të mbrojtjes së natyrës; 2.3. vendosjes së kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe planet e menaxhimit me të mirat e natyrës në veprimtaritë e xehetarisë, bujqësisë, pylltarisë, gjuetisë, peshkatarisë, hidro-ekonomisë si dhe veprimtarive tjera me ndikim në natyrë; 2.4. hartimit të raporteve për gjendjen e natyrës, nxjerrjen dhe zbatimin e strategjisë, programeve, planeve të veprimit dhe planeve të menaxhimit; 2.5. përcaktimit të vlerave të natyrës dhe vlerave të mbrojtura të natyrës; 2.6. themelimit të sistemit për administrim me vlerat e natyrës dhe vlerat e mbrojtura të natyrës; 2.7. lidhjes dhe harmonizimit të sistemit shtetëror me sistemin ndërkombëtar për mbrojtjen e natyrës; 2.8. inkurajimit të hulumtimeve shkencore në lëmin e mbrojtjes së natyrës; 2.9. njoftimit të publikut me gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës; 2.10. inkurajimit dhe mbështetjes të mbrojtjes së natyrës përmes ngritjes së vetëdijes së publikut, posaçërisht përmes procesit të arsimimit.

Neni 141

LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES
LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES

1. Strategjia i përcakton qëllimet dhe synimet afatgjata të ruajtjes të larmisë biologjike dhe peizazhore dhe vlerave të mbrojtura të natyrës, mënyrën e zbatimit të tyre, në pajtim me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, shoqëror e kulturor të Republikës së Kosovës.

2. Strategjia hartohet në bazë të raporteve për gjendjen e natyrës dhe mbrojtjen e natyrës këtu e tutje: - raporti për gjendjen e natyrës - dhe kryesisht përmban:[...]

2.8. synimet për informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje për natyrën:[...]

Neni 151

LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES
LIGJI Nr. 03/L-233
LIGJIN PËR
MBROJTJEN E
NATYRES

Pjesëmarrja e publikut në vendim marrje

1. Gjatë hartimit të akteve ligjore, përkatësisht akteve për shpalljen e vlerave të mbrojtura të natyrës, planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura dhe planeve për shfrytëzimin e të mirave të natyrës si dhe dispozitave të përgjithshme ligjore të zbatueshme dhe të detyrueshme dhe dokumenteve në fushën e mbrojtjes së natyrës, duhet të sigurohet pjesëmarrja e publikut.

2. Publiku duhet të informohet për procedurën nga paragrafi 1. i këtij neni përmes lajmërimit publik.

LIGJI Nr. 04/L-147
PËR UJËRAT E
KOSOVËS
LIGJI Nr. 04/L-147
PËR UJËRAT E
KOSOVËS

Neni 6 para 1.11

Parimin e pjesëmarrjes së palëve të interesuara - organet kompetente janë të detyruara që të sigurojnë, që në procedurën për miratimin e dispozitave, dokumenteve strategjike, plan - programeve dhe vendimeve të marrin parasysh interesat e palëve të interesuara;

Neni 3

LIGJI Nr. 04/L-147
PËR UJËRAT E
KOSOVËS
LIGJI Nr. 04/L-147
PËR UJËRAT E
KOSOVËS

Qasja në informata

Rregullon çështjet që kanë të bëjnë me: qasjen në informata që lidhen me ujërat, pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes që ka të bëjë me menaxhimin e ujërave, vlerësimin e ndikimit nga strategjitë e ndryshme, planet dhe programet mbi mjedisin, vlerësimin e ndikimeve nga projektet e caktuara, pengimin dhe kontrollin e avarive me praninë e materieve të rrezikshme, lejet e integruara ekologjike për punë dhe instalime që ndikojnë në mjedisin ujor

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim:

LIGJI NR. 08/L-181
PËR VLERËSIMIN
E NDIKIMIT NË
MJEDIS
LIGJI NR. 08/L-181
PËR VLERËSIMIN
E NDIKIMIT NË
MJEDIS

1.1. të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike apo private;

1.2. të përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private;

1.3. garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative, gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Europian dhe Këshillit e dt.16 prill 2014 e cila ndryshon Direktivën 2011/92/EU mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të caktuara publike dhe private.

Neni 4

Parimet

- LIGJI NR. 04/L-174
PËR
PLANIFIKIMIN
HAPËSINOR
LIGJI NR. 04/L-174
PËR
PLANIFIKIMIN
HAPËSINOR
1. Planifikimi hapësinor dhe rregullimi duhet të bazohen në parimet e mëposhtme:
 - 1.2. promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndër-sektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor;
 - 1.3. promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor;
 - 1.8. promovimin e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor;

decisionTitle* **decisionDescription***

4967/89 | Legal Summary | 19/02/1998

Guerra k. Italise

Në rastin Guerra dhe të tjerët, Gjykata vërtetoi se Italia e kishte shkelur nenin 8, në aspektin e jetës private dhe familjare, lidhur me atë se kishte dështuar në informimin e popullatës lokale rreth faktorëve të rrezikut dhe rreth mënyrës së veprimit në rast të ndonjë aksidenti në fabrikën kimike që gjendej në afërsi. Paditësit shprehimisht i kishin kërkuar ato informata nga autoritetet kompetente vendore. Ato përfundimisht ishin dhënë vetëm pas mbylljes së prodhimit industrial.

Smaltini v. Italy

24 Mar. 2015

Smaltini v. Italy

Ky rast kishte të bënte me efektin e ndikimit mjedisore, të shkaktuar nga veprimtaria e fabrikes së çelikut, mbi shëndetin e aplikantit të parë, i cili vdiq nga leukemia. Burri i saj dhe fëmijët, të cilët kanë parashtruar kërkesën në GJEDNJ, pohojnë në mënyrë të veçantë mbi ekzistencën e një lidhje shkakore midis emetimeve të dëmshme nga fabrika dhe zhvillimit të kancerit të aplikantit. Gjykata e shpalli kërkesën si qartazi të pabazuar. Sipas mendimit të Gjykatës, aplikanti nuk kishte demonstruar, në dritën e të dhëna shkencore të disponueshme në kohën e ngjarjeve, se kishte pasur një shkelje të këtij aspekti procedural të së drejtës së saj për jetë.

decisionTitle* **decisionDescription***

Olui? v. Croatia, no. 61260/08, §§ 52–62, 20 May 2010

Olui? v. Croatia

Gjykata vendosi që gjersa nuk ka njëjtë drejtë për një mjedis të shëndosh sipas KEDNJ, kur një individ është direkt i prekur nga zhurma ose format e tjera të ndotjes, mund të zbatohet neni 8 i KEDNJ-së. Gjykata theksoi se ndërsa neni 8 në thelb ka për qëllim mbrojtjen e individit kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike, ky nen mund të përfshijë autoritetet që marrin masa të cilat janë krijuar për të siguruar respektimin e jetës private, madje edhe në sferën e marrëdhënieve midis vetë individëve privatë. Sidoqoftë, për të përcaktuar nëse neni 8 është shkelur, një vëmendje e veçantë duhet kushtuar interesave konkurrues të individit dhe komunitetit. Gjykata gjeti se autoritetet përkatëse publike kishin dështuar t'i ndalonin palëve të treta që të shkelnin të drejtat e aplikantit sipas neni 8 të KEDNJ-së.

Önery?ld?z v. Turkey

GjEDNJ-ja në rastin *Önery?ld?z v. Turkey* lidhur me dështimin e autoriteteve për informimin e publikut dhe për ndërmarrjen e masave efektive dhe parandaluese, kishte gjetur shkelje të nenit 2, për arsye të mungesës së ndërmarrjes së hapave të duhur nga shteti për të parandaluar vdekjen e nëntë banorëve që jetonin pranë një deponie mbeturinash. Gjykata *vuri në dukje në veçanti mungesën e informimit të banorëve lidhur me rrezikun që ata ballafaqoheshin duke jetuar në atë vend. Sipas gjykatës, edhe nëse do të kishte informata, shteti është përgjegjëse, pasi që nuk kishte ndërmarrë masat e nevojshme praktike për të shmangur rreziqet për jetën e njerëzve*